



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2020:092829

Datë: 03.11.2021

Numri i dokumentit: 02355723

C.nr.101/2020

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, në përbërje nga gjyqtari Hajrullah Aruqi, në çështjen juridike të paditëses V.. J.. nga fsh., komuna Skenderaj, të cilën e përfaqëson me autorizim Av. ... nga, kundër të paditurës K.e S. – D. K. e Sh., të cilën e përfaqëson me autorizim ..., për kompensim të pagave jubilarë në vlerën prej 1,302.24 euro, pas mbajtjes dhe përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor me dt.14.10.2021 me pjesëmarrjen e palëve ndërgjyqësve, me dt.01.11.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses V., J., nga fshati ... i ..., Komuna Skenderaj.

DETYROHET e paditura Komuna Skenderaj – Drejtoria Komunale për Shëndetësi që paditëses në emrin e 3 pagave jubilarë për përvojën e punës mbi 30 vite si punonjëse operatore SISH-it në QKMF Skenderaj t'i paguaj sipas pagës bazë prej 434.08 euro shumën e përgjithshme 1,302.24 euro, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë: 104 euro për hartim të padisë, 30 euro taksë për padi, 135 euro për një përfaqësim të avokatit, gjithsejtë shpenzime në shumën prej 269 euro të gjitha këto shuma duhet të paguhet me kamatë ligjore në normën prej 8%, në afatin prej 7 dite nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi në nën kërcenim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësja përmes përfaqësuesit me autorizim me padinë e ushtruar në gjykatë ka kërkuar që të detyrohet e paditura të i shpërblej 3 paga jubilarë në lartësin prej 1,302.24 euro me arsyetimin se është e punësuar në QKMF në Skenderaj dhe ka themeluar marrëdhënie të punës me dt.01.06.1983, ku vazhdon edhe me tutje të punoje dhe gjatë këtyre viteve ka arritur përvojën e punës mbi 30 vite dhe sipas Kontratës Sektoriale për Shëndetësi i takojnë 3 paga jubilarë në lartësinë e pagës se fundit bazë. Pas administrimit të provave gjate seancës së shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare i propozoi gjykatës aprovimin e padis si të bazuar dhe paditëses nga paga bazë e fundit

prej 434.08 euro, ti paguaj shumën e përgjithshme të 3 pagave në lartësinë prej 1,302.24 euro si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 269 euro.

Përfaqësuesi i të paditurës në fjalën përfundimtare e kundërshtoi padinë dhe kërkesën e saj me arsyetimin se kontrata sektoriale e shëndetësisë e nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Sindikata e punëtorëve shëndetësor është hartuar dhe përpiluar me kundërshtim me aktin me të lartë juridik siqë është kushtetuta andaj mbesim pran kundërshtimeve se baza juridike është kontestuese dhe kërkojmë nga gjykata që padinë dhe kërkesëpadinë ta refuzoj si të pa bazuar.

Gjykata me qëllim të konstatimit të drejtë dhe të plot të gjendjes faktik në çështjen konkrete juridike në kuptim të nenit 8 të LPK-së i nxori dhe i administroi të gjitha provat e shënuara në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor me dt.14.10.2021 një nga një dhe të gjitha së bashku duke i krahasuar njëra me tjetrën nga të cilat rezulton se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë.

Gjykata prej kontratës së punës numër 1/263 m. L.A. e dt.03.01.2014 e lidhur në mes të paditurës si punëmarrës dhe të paditurës si punëdhënës konstatohet se kontrata e punës në kohë të pacaktuar tregon se paditësja e lindur me dt...., me përgatitje Sh. M.e E. – punonjëse operatore e në kuadër të QKMF-së ka themeluar marrëdhënien e punës me dt..... dhe ka përvojë të punës mbi 30 vite.

Prej vërtetimit të lëshuar nga Q...- Skenderaj nr.380/019 i dt.01.11.2019, konstatohet se paditësja punon si punonjëse Operatore e SISH-it në kuadër të Q...së ka themeluar marrëdhënie të punës me dt....., ku i njëjti sipas vërtetimit të lartcekur punon si punonjëse Operatore e në kuadër të Q...-së dhe ka përvojë të punës mbi 30 vite.

Gjykata për lartësinë e pagës bazë është mbështetur në transaksionin e xhironlogarisë për paditësin të lëshuar nga banka BKT për pagat e fundit me dt.01.11.2019 nga është konstatuar se paditësi ka realizuar pagën prej 434.08 euro dhe sipas kësaj page paditëses 3 pagat jubilarë e arrijnë shumën prej 1,302.24 euro.

Gjykata bazën ligjore për miratimin e kërkesës së paditëses në tërësi si të bazuar e gjejnë në Kontratën Kolektive Sektoriale Nr.05/L-3815 e dt.12.06.2018, ku në nenin 17 par.3 shprehimisht është përcaktuar “Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë...” në paragrafin 3.3 të po këtij neni shprehimisht thuhet “Për 20 vite të përvojës së punës në institucionin shëndetësor të punëdhënësi i fundit, në vlerë të 3 paga mujore të tijë”. Në paragrafin e 4 është përcaktuar “punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. Shpërblimi jubilar, paguhet me afat prej 1 muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”. Në bazë të kërkesës së paditëses Nr.08-120/01-0069650/19 e dt.19.11.2019, konstatohet se paditësja i ka shterur mjetet juridike në procedurën administrative për realizimin e te

drejtës se saj por pasi që nuk ka marr përgjigje nga e paditura brenda afatit ligjor në përputhje me dispozitat e nenit 79 të Ligjit të Punës ka ushtruar padi në gjykate për mbrojtje Gjyqësore.

Gjykata në bazë të provave të administruara ka vërtetuar se padia e paditëses në tersi është e mbështetur në provat faktike dhe në bazën juridike të përmendur më lartë, prandaj e njëjta në tersi është e themeltë. Me rastin e vendosjes e çështjes konkrete juridike gjykata mori për bazë faktin se e paditura në bazë të kontratës sektoriale për shëndetësi ka qenë e obliguar që vullnetarisht të e përmbush detyrimin sipas kontratës së lartpërmendur.

Me rastin e vendosjes të çështjes konkrete juridike gjykata mori për bazë dispozitat e nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës nr. 03/L/212 ku shprehimisht thuhet “Marrëveshja kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara në marrëveshje të tillë kolektive”

Gjykata i vlerësoi të gjitha kundërshtimet e palës së paditur të paraqitura me përgjigje në padi dhe gjate shqyrtimit kryesor të cilat i kanë të bëjnë me pretendimin se kontrata kolektive sektoriale e shëndetësisë është atakuar në gjykate kompetente për vlerësim të ligjshmërisë por deri me tani kësaj gjykatë nuk iu ka prezantuar asnjë provë me të cilën do të vërtetohej se gjykata kompetente ka marr ndonjë vendim për caktim të ndonjë mase të përkohshme apo pezullim të zbatimit të kontratës dhe për këto arsye pretendimet e palës së paditur nuk janë të argumentuara me asnjë prove prandaj nuk kanë ndikim që të vendoset ndryshe nga ajo që është vendosur në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi që pala e paditur të i bart shpenzimet procedurës kontesimore në shumën e përgjithshme prej 269 euro është i bazuar në dispozita të nenit 452 par.1 të LPK-së , ndërsa vendimi që shumat e lartpërmendura të paguhen me kamatën ligjore në normën prej 8% është iu bazuar në dispozitat të nenit 383 par.1 dhe 2 të LMD-së nr.04/L-077.

Me sa u tha më lartë konform dispozitat të nenit 143 të LPK-së u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
C.nr.101/2020, me dt.01.11.2021

Gjyqtari
Hajrullah Aruqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 7 dite nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nëpërmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.